



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 5020/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:
 - Gjeodezi, BSc, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Hidroteknikë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Hidroteknikë, MSc, 120 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik.
 - Konstruktiv, BSc, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
 - Konstruktiv, MSc, 120 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik.
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Ndërtimtarisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Gjeodezi, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Bashkim Idrizi Përparim Ahmeti Abdullah Zejnullahu
2	Hidroteknikë, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Esat Gashi Naim Hasani Hajdar Sadiku
3	Hidroteknikë, MSc, 120 ECTS Ri-akreditim	Laura Kusari Ragip Hadri Zijadin Guri
4	Konstruktiv, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Qani Kadiri Fatos Pllana Arton Dautaj
5	Konstruktiv, MSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Naser Kabashi Misin Misini Milot Muhaxheri

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar tri vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Ndërtimtarisë Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 19.03.2021, 30.03.2021 dhe më 23.04.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Stephan Pinkau, Mikus Dubickis, Gabor Dombay dhe Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit Gjeodezi, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht pesë (5), e përmbush pjesërisht një (1).
2. Për programin e studimit Hidroteknikë, BSc, 180 ECTS --, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht gjashtë (6).
3. Për programin e studimit Hidroteknikë, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht pesë (5).
4. Për programin e studimit Konstruktiv, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht gjashtë (6).
5. Për programin e studimit Konstruktiv, MSc, 180 ECTS nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht gjashtë (6).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Ndërtimtarisë
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

